

1420
13. 3 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"

Nr.1999 Prot.

Tiranë, më 02.02.2024

Nr.296-23 Regj.

URDHËR

PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit

TIRANË ✓

Për dijëni: Debitorit – Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP (OSHEE - GROUP) - sha me Nipt: K72410014H

Adresa: Tirane, Njësia Administrative Nr. 7, Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H. 1, 1023

Për dijëni: Kreditorit – Albert Gjini; Edona Gjini; Deivi Gjini; Deon Gjini

Adresa: Zejmen, Lezhë

Unë, Ardit Hajdini Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "ASTREA" shpk Nipt: L61306025U, në referim të Titullit Ekzekutiv Numër vendimi 391, datë 27.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, dhënë me ekzekutim të përkohshëm, kam vënë në ekzekutim këtë *Titull*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.296-23, datë 30.06.2023 kërkesën e kreditorit Albert Gjini; Edona Gjini; Deivi Gjini; Deon Gjini ndaj debitorit Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP (OSHEE - GROUP) sha me Nipt: K72410014H.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2001 Prot, Datë 30.06.2023, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Titulli Ekzekutiv Numër vendimi 391, datë 27.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, dhënë me ekzekutim të përkohshëm, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Kulla Nr.4, Kati 11, Ap.3 Tiranë Cel +355 676950155
e-mail : sheerbimipermbarimorastrea@gmail.com

KONSTATOVA:

Me urdhër Nr.2106 Prot, Datë 14.07.2023 është Urdhëruar Vendosja e Sekuestros Konservative pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në aktivet e debitorit Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP (OSHEE - GROUP) - sha me Nipt: K72410014H.

Me kërkesën e kreditorit Albert Gjini; Edona Gjini; Deivi Gjini; Deon Gjini është kërkuar pushimi i dosjes dhe tërheqja e Titullit Ekzekutiv (origjinal).

Në këto kushte, në zbatim të nenit 616 Pika (b), nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit Nr.26/2019, miratuar më datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. ***Heqjen e masës së Sekuestros Konservative***, të vendosur me anë të Urdhërit Nr.2106 Prot, Datë 14.07.2023 në aktivet e debitorit:

- **Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP (OSHEE - GROUP)**
- sha me Nipt: K72410014H.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju bëj me dije se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ARDIT HAJDINI

